



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
22.03.2021, duke filluar në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci.

Munguan: Egzon Azemi, Genc Sherifi dhe Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Fatos Dibra, shef i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues, duke thënë se sot jemi në mbledhjen e jashtëzakonshme të KPF-së, me këtë

### REND DITE :

1. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021;
2. Propozimvendimi për autorizim të buxhetit;
3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës.

**Fadil Gashi**, para se të fillojnë diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, u interesua lidhur me pikën e tretë, gjegjësisht se ku gjendet kjo.

**Kryesuesi** dha sqarime, duke cekur se është fjala për te Posta, ku do të ndërtohet xhamia e re. Bashkësisë Islame të Kosovës i janë dhënë kushtet e ndërtimit, dhe kushtet e ndërtimit e parashohin edhe një qasje të re. Aty janë disa banorë që duhet t'u bëhet zgjidhja e problemit, por materialin nuk kanë mundur me përgatitur dhe pa u zgjidhur kjo çështje punimet nuk mund të fillojnë.

**Agim Gashi** kërkoi që nëse nuk është shumë urgjente, le të mbetet për seancën tjetër, pasi që nuk ka material.

Faqe 1 nga 5





**Kryesuesi** tha se materiali vjen, por të shtyhet për shkak të kushteve të ndërtimit.

**Agim Gashi** theksoi se këshilltarët kanë nevojë me hulumtuar para se me votuar, andaj është e rrugës që, nëse nuk bëhet vonë, kjo pikë të jetë pas dy javësh.

**Kryesuesi** tha problemi është se në fund të muajit kushteve të ndërtimit u skadon afati, pastaj duhet prapë procedura nga fillimi.

**Fatos Dibra** bëri të ditur se ligjërisht mund të vazhdojë edhe për një vit tjetër.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se ata është dashur ta bënin kërkesën më herët.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke cekur se si problematikë është kaherë, por është menduar qysh me zgjidhur si problematikë, se toka është e Komunës, por ka objekte të ndërtuara në tokë të Komunës.

**Agim Gashi** theksoi se Bashkësia Islame duhet me ju ofruar zgjidhje këtyre banorëve, le t'ua zgjidhë problemin dhe ne e votojmë.

## **Pika e parë**

### **Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021.**

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se për bartje që i keni në material, janë pas ndryshimeve që i ka bërë Thesari, disa kthime që nuk ka mundur për shkak të mungesës monetare, unë e kam bërë siç e kemi bërë projektbuxhet propozimin prej propozimit, kanë mbetur 46 milionë 512 € dhe kemi ardhur deri te 34 milionë e 347 €, e kam bërë shpalosjen, mundem edhe pak më në detale me hyrë. Prej këtyre granteve qeveritare diku rreth 10 milionë janë hequr, 4 milionë nuk kemi mundur me i mbledhur të hyra, d.m.th. edhe pse 85% ka qenë në pandemi, por nuk i kemi mbledhur as sa i kemi propozuar, janë të hyra indirekte sipas Ministrisë së Financave, janë shkak gjobat e trafikut, gjobat e gjykatës, ajo e pyjeve, që janë të hyra indirekte, të cilat nuk na ka lejuar me i planifikuar, por na i kanë qitur paratë si i kanë mbledhur, dhe ato ia kemi shtuar dhe ka qenë një rikthim në muajin e dytë, prej 124 mijë 242€, një pagesë që llogaria ka qenë gabim, por kjo është dashur me u lajmëruar së paku në shkurt, por pasi kanë bërë pasqyrat financiare e kanë kthyer, sepse llogaria që e ka kthyer banka nuk ka qenë mirë. Ne e kemi kontaktuar kompaninë dhe e kemi njoftuar për këtë rast.

Prej këtyre 34 milionë e 347,176.00 euro, 6 milionë e 724 mijë euro janë obligime qoftë me vendim të Kuvendit, qoftë me premtim të kryetarit, obligimet që i kemi ndaj qytetarëve, subvencionet veç i kemi ndarë çka janë, mirëpo krejt këto 6 milionë e 724 mijë euro janë obligime që janë të miratuara.

**Agim Gashi** u interesua se a kanë hyrë edhe premtimet për subvencionet për autobusët privatë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha jo, nuk janë përfshi subvencionet për autobusët privatë, kryetari ka thënë se kur të kryhet kjo duhet me shikuar se çka na qesin tani prej



subvencioneve të kryetarit, se për momentin subvencione të kryetarit janë vetëm 400 mijë euro.

**Sami Boroci** pyeti se sa është vlera e këtij vendimit të fundit që e keni marrë në Kuvend se nuk kam qenë prezent.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se nuk ka qenë Vendim, por rekomandim dhe pasi të bëhet aprovim i kësaj shikojmë mjetet çka i mbledhim, që na lejon Ministria me i qitë aty dhe me caktuar kryetari një çmim.

**Agim Gashi** theksoi se a na duhet me na ardhur prapë ndonjë propozim në Kuvend pasi të bëhet planifikimi dhe përlllogaritja për koston e atij shërbimi. P.sh. vjen propozimvendimi për subvencionim të atyre linjave të kontraktorëve privatë, që nënkupton 60% e linjave, dhe nëse na vjen qeveria, është e detyruar me bërë një parallogaritje me ditë sa është kostoja e asaj pune, sepse kërkesa mund të vijë dhe ne nuk mundemi me votuar në Kuvend, nëse nuk na vjen ajo, dhe Qeveria nuk ka interes, pa e bërë një planifikim sa mundet me financuar, sepse ndaj Trafikut Urban Komuna ka një obligim ligjor, ndërsa ndaj atyre e bën për hir të interesave zhvillimore të asaj fushe dhe të qytetarëve që shërbejnë në ato linja. Obligimi ligjor ndaj Trafikut është kredia, por tani është paraqitur nevoja në kuadër të "Pakos ekonomike" me i përfshirë edhe këto veprimtari dhe me u ndihmuar njerëzve, ne jemi për, por duhet me u planifikuar buxheti dhe ai buxhet duhet me u miratuar në Kuvend.

A mundemi ne tani me mbuluar ose me krijuar kodin buxhetor, ose nëse nuk duhet kodi me u paraparë në mallra dhe shërbime, dhe nëse ka ndonjë sasi mjetesh të lira në bartje me i bartë në atë kod.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se kodi është bazë themelore e subvencioneve të kryetarit të administratës, d.m.th. nuk kemi mundësi tjetër vetëm të llogaritja e mallrave.

**Agim Gashi** u shpreh se atë financim subvencionet e kryetarit nuk e mbulojnë, një pjesë duhet paguar prej mallrave dhe shërbimeve.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime të nevojshme.

**Agim Gashi** u shpreh që ta keni parasysh Ligjin për transport, aty ka edhe udhëzim administrativ për subvencionimin e linjave të paqëndrueshme, ku thotë se në linjat e paqëndrueshme subvencionohet bileta. Tash a vendosin përmes kilometrazhit apo përmes shitjes së biletave? Ajo është çështje e Komunës, përkatësisht e Qeverisë, sepse operatorët detyrohen me i ndërprerë linjat, se nuk mund të punohet me humbje çdo ditë, këtu është problemi.

**Fadil Gashi** tha se ne kemi bërë gabimin më të madh që i kemi lejuar një muaj pa para, shefat e grupeve parlamentare është dashur të ndërhyjnë.

**Kryesuesi** u shpreh se ne po reagojmë, por duhet pasur vendosmëri dhe në emër të grupeve parlamentare me deklaruar se propozimet që vijnë aty për aty nuk i pranojmë.

**Fadil Gashi** iu drejtua kryesuesit se ne po vendosim këtu, ndërsa ti po i futë pikat jashtë rendit të ditës.

**Kryesuesi** tha se rendin e ditës unë këtu nuk e vendosi, por atë e caktojme në marrëveshje me kryetarin, por kur ju thoni si SHGP-së, unë duhet me qitur në votim, e ju nëse doni mund të mos e votoni.



**Vala Peshku** u shpreh e pajtimit me qëndrimin e parafolësit, Fadilit.

**Kryesuesi** sqaroi, duke thënë se bëhet propozimi, ju jepet fjala SHGP-ve, thoni se nuk e përkrahim, duhet me i ndjekur rrugët procedurale, qitet në votim, rrëzohet, kryhet.

**Vala Peshku** theksoi se prej fillimit e kemi cekur se propozimet që vinë ad-hoc pa elaborim financiar as në diskutim mos me i qitur.

**Agim Gashi** theksoi se Kuvendi i ka trupat punues, Kuvendi e ka një shërbim të Kuvendit, Kuvendi e ka një Zyrë ligjore që i përcjell zhvillimet dhe ju mbretërit e ligjit duhet me ia shpjeguar.

**Halim Halimi** u shpreh se shefi i Zyrës ligjore nuk ka të drejtë me ndalur, aty është ekzekutivi i cili shpjegon dhe e ndalon.

**Vala Peshku** tha se ekzekutivit llupën ia mbanë Kuvendi edhe me dalë Kryetari dhe drejtorët me thënë kështu - kështu, nëse ka implementime financiare të cilat neve nuk na pëlqejnë si Kuvend, nuk jam kundër, se ne jemi kontrollues i ekzekutivit, Kuvendi është kontrollues i ekzekutivit dhe ne e aprovojmë buxhetin.

**Halim Halimi** theksoi se implementimet financiare, kur thotë kryetari nuk ka mjete financiare, aty na duhet me u ndalur.

**Vala Peshku** tha se ky do të duhej të ishte standard që nga fillimi, nga dita e parë kur kemi ardhur.

**Fadil Gashi** tha se po vendosim për çdo pikë që vjen e papërgatitur të mos futet në rendin e ditës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për autorizim të buxhetit.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për autorizim të buxhetit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës.**

**Vala Peshku** thekso se nuk kemi material.

**Kryesuesi** tha se nuk kemi material, por vetëm këto sqarime që i dhamë më herët.

**Vala Peshku** pyeti se a mundemi me hequr nga rendi i ditës, pse të diskutojmë ne në KPF një pikë ose pse me ia dhënë të drejtën një pike për diskutim nëse nuk e kemi materialin.

**Fatos Dibra** informoi se në orën 11:00, Drejtoria e Pronës i ka dërguar në e-mail disa materiale lidhur me BVI-në.



Kryesuesi tha se nëse i kemi materialet ua dërgojmë menjëherë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:25.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta

